

**Njoftim për Përqendrim i cili i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Enmon
d.o.o. Beograd, Republika e Serbisë dhe Alteria EOOD, Bullgari mbi Keramika
Kanjizha, Republika e Serbisë**

(lënda nr. 08-91 /2025)

Sipas nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 30.05.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Enmon d.o.o. Beograd me seli të regjistruar në Bulevar Osloboxhenja 205, 1100 Beograd, Serbi dhe Alteria EOOD me seli të regjistruar në Slavjanska 5, kati 3, 1000 Sofje, Bullgari do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Keramika Kanjizha me seli të regjistruar në rrugën Horgoshki bb, 24420 Kanjizha, Serbi.

ENMON d.o.o. Beograd është pjesë e grupit Enmon, i cili është aktiv në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të pllakave qeramike, granit qeramike, sanitari dhe pajisjeve të lidhura për banja, objekte publike dhe banimi. Grupi ka mbi 1.200 të punësuar në tetë shtete dhe ofron një sistem të plotë për instalimin e qeramikës me të gjitha materialet përcjellëse. Enmon d.o.o. Beograd është aktiv në Maqedoninë e Veriut përmes dy shoqërive të lidhura:

- Shoqëria për tregti dhe shërbime transporti ENMON eksport-import SHPKNJP Veles me seli në rr. Oliver Kitanovski nr. 119, Veles, Shkup, Maqedonia e Veriut, me veprimtari të regjistruar – Tregti me shumicë të drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare;
- Shoqëria për autotransport dhe tregti ENMON-TRANSPORT eksport-import SHPKNJP Veles me seli në rr. Oliver Kitanovski nr. 119, Veles, Shkup, Maqedonia e Veriut, me veprimtari të regjistruar – Transport rrugor i mallrave (“**Enmon Transport**”).

ENMON eksport-import SHPKNJP Veles dhe Shoqëria për autotransport dhe tregti ENMON-TRANSPORT eksport-import SHPKNJP Veles shesin mallra dhe gjenerojnë të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

-Alteria EOOD funksionon në kuadër të grupit të shoqërive SPSC Invest, i cili bashkon një numër të madh shoqërish të përfshira në veprimtari të ndryshme. Alteria EOOD nuk ka shoqëri të lidhura, filiale apo përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, por realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes së mallrave.

-Keramika Kanjizha është një prodhues serb i pllakave qeramike, i cili vepron në treg prej 40 vitesh. Shoqëria është aktive në prodhim dhe tregtinë me shumicë, duke përdorur teknologji dhe makineri moderne nga Italia. Ofron një gamë të gjerë produktesh, si pllaka qeramike për dysheme dhe mure, si dhe pllaka porcelani të cilësisë së lartë. Kanjizha i plasoi produktet e saj në tregun e Serbisë dhe në vendet e Evropës Juglindore. Keramika Kanjizha nuk ka shoqëri të lidhura, filiale apo përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, por realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes me shumicë nga Serbia.

Spektori ekonomik i prekur nga përqendrimi është shitja me shumicë.

Në përgjithësi, transaksioni i propozuar i referohet kryesisht tregut të prodhimit dhe të pllakave qeramike, por nuk ka ndikim në konkurrencën në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

04.06.2025

Shkup